

# Lufta në Ukrainë: Propaganda dhe dezinformimi





# **Lufta në Ukrainë: Propaganda dhe dezinformimi**

**Autorë:** Shkelzen Osmani, Alban Zeneli

**Lektore:** Adelinë Selmani

**Publikues:** ADS/hibrid.info, Departamenti i Gazetarisë/Fakulteti i Filologjisë/Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Prishtinë, mars 2022

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info dhe Departamenti i Gazetarisë në Universitet të Prishtinës. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

## Përmbajtja

Përmbledhje.....	4
Përmbajtja mediatike dezinformuese në Kosovë .....	5
Konteksti i lajmeve të publikuara për audiencën kosovare dhe shqipfolëse në përgjithësi.....	6
Bota: Përmbajtja mediatike dezinformuese .....	7
Narrativat e falsifikuara .....	10
Metodologjia dhe të dhënat .....	11
Rekomandimet.....	12
Rekomandimet për redaksitë e lajmeve.....	12
Rekomandime për publikun.....	13

## Përmbledhje

Ky raport paraqet numrin, llojin dhe formatin e lajmeve të rreme dhe të mënyrave të tjera të dezinformimit, të trajtuara që nga periudha kur ka nisur pushtimi i Ukrainës nga Rusia.

Ky raport i shkurtër është ideuar nga platforma për kontroll të fakteve “hibrid.info” dhe është realizuar në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Hartimi i raportit është i bazuar në të dhënat e siguruar nga baza e të dhënave e trajtimeve të dezinformative e lajmeve të rreme nga kontrolluesit e fakteve nga mbarë bota, anëtarë (nënshkrues të verifikuar) të Rrjetit Ndërkombëtar të Kontrolluesve të Fakteve “International Fact Checking Network” (IFCN). Përmes një kërkesë zyrtare, “hibrid.info” është lejuar që t’i përdorë të dhënat e kësaj baze në shërbim të hartimit të këtij raporti. Duhet potencuar se ideja për krijimin e kësaj baze me të dhëna, ka lindur nga platforma për kontroll të fakteve, nga Spanja, “Maldita.es”, që me kalimin e kohës është lancuar edhe në formën online e titulluar “ukrainefacts.org”.

Kjo bazë e të dhënave përbëhet nga trajtimet/denoncimet e informatave që ndërlidhen me luftën në Ukrainë, që nga data 24 shkurt 2022, ditën kur ka filluar invazioni ushtarak rus në territorin e Ukrainës.

Në këtë raport do të paraqiten, të përmbledhura në grafikë dhe përshkrim narrativ, numri, llojet e format e dezinformimit, si dhe kanalet që janë përdorur për t’i shpërndarë ato.

Në pjesën kryesore të raportit paraqiten gjetje rreth shpërndarjes së dezinformimit në formën e artikujve/postimeve (përmbajtje me tekst) dhe foto/video/audio – përmbajtjeve në Kosovë e rajon. Gjithashtu, në këtë seksion do të trajtohet edhe konteksti i përmbajtjeve dezinformuese. Në vazhdim, raporti trajton fenomenin e krijimit të narrativave fiktive të situatës në Ukrainë nga mediumet pro-Kremlinit. Në pjesën e fundit të raportit paraqiten rekomandimet e dala nga gjetjet, të cilat janë të ndara në dy pjesë; rekomandimet për redaksitë e lajmeve në Kosovë dhe rekomandimet për audiencën e medieve në gjuhën shqipe.

## 1. Përmbajtja mediatike dezinformuese në Kosovë


Në rastin e Kosovës, të dhënat janë siguruar nga dy platformat për kontroll të fakteve “hibrid.info” e “kallxo.com”, të cilat janë anëtare të IFCN-it.

Nga 24 shkurti e deri më 11 mars, kur kanë përfunduar mbledhja e përpunimi i raportit, numri i trajtimeve nga këto dy platforma ka arritur në 38. Kjo nuk do të thotë se numri i krijimit dhe i shpërndarjes së informacioneve të pasakta apo dezinformuese është i njëjtë me rastet e trajtuara, pasi ai është shumë i madh.

Mirëpo, duke u bazuar në metodologjinë e hulumtimit të të dyja platformave, një rast i trajtuar përfshin edhe publikime të tjera të ngjashme, të cilat mund të jenë shumëfish më të mëdha. Por, duke qenë se, nuk ka të dhëna/inpute të sakta, në raport janë trajtuar vetëm ato që janë futur në kuadër të bazës së të dhënave të IFCN-it.

Mediet apo kanalet që kanë shpërndarë më së shumti informata të pasakta dhe dezinformuese kanë qenë mediet online, ku hyjnë të gjitha llojet e medieve që janë prezente në hapësirën digjitale.


Shumica e artikujve të publikuar nga mediet e Kosovës, e që janë vlerësuar si dezinformata, janë përmbajtje të krijuara nga mediet apo krijues e distribuues jashtë vendit, në gjuhë të tjera (jo shqip). Pra, janë të përkthyer dhe të shpërndara. Format i përmbajtjes së pasakte apo dezinformuese, në shumicën e rasteve, ka ardhur si artikull mediatik, i përbërë nga teksti/videoja apo teksti/fotografia. Më pak raste ka pasur me vetëm fotografi apo vetëm video, që ka mundur të jetë publikuar nga profile, faqe apo grupe në medie sociale.



**Figura 1.** Format kryesore të shpërndarjes së dezinformatave në rastin e Kosovës, sipas denoncimit në IFCN.

Kanali që është përdorur më së shumti për shpërndarje të këtyre lloj artikujve ka qenë media sociale dominuar nga Facebook-u, që vazhdon të mbetet më i përdoruri nga audiencia në Kosovë<sup>1</sup>. Një përqindje në këtë

platformë janë publikuar si postimet (në profile, faqe apo grupe) dhe rastet kur mediet online e kanë përdorur këtë platformë për të shpërndarë linqet e tyre me përmbajtje dezinformuese.



**Figura 2.** Kanalet kryesore të shpërndarjes së dezinformatave në Kosovë, në bazë të denoncimit në IFCN.


## 1.2. Konteksti i lajmeve të publikuara për audiencën kosovare dhe shqipfolëse në përgjithësi

Një pjesë e madhe e artikujve/postimeve kanë pretenduar të paraqesin ngjarje apo veprime që kanë ndodhur gjatë luftimeve në Ukrainë.

Por, ka pasur edhe raste kur janë ndërlidhur ngjarjet në Ukrainë me zhvillimet në rajon e Kosovë. Kjo ka ndodhur kryesisht duke qenë se udhëheqësit politikë e institucionalë të

Rusisë, përfshirë edhe vetë presidentin Vladimir Putin, kanë përmendur disa herë Kosovën në deklaratat e qëndrimet e tyre politike, duke u munduar të tërheqin paralele mes vendimit për pushtim, fillimisht të rajoneve separatiste Doneck e Luhanks, e më pas edhe të Ukrainës në tërësi, me intervenimin ushtarak të NATO-s në vitin 1999.

<sup>1</sup> [STIKK-Internet Penetration and Usage in Kosovo](#)



**Figura 3.** Konteksti i dezinformatave të publikuara në mediet në gjuhën shqipe, sipas denoncimit në bazën e të dhënave të IFCN-it.

Ndërlidhje të tilla janë bërë edhe përmes përmbajtjeve tërësisht të fabrikuar/sajuar. Këto ndërlidhje konteksti janë bërë kryesisht me tituj të sajuar që pretendojnë se po përgatitet një pushtim ushtarak i Serbisë në Kosovë, pas atij rus në Ukrainë. Përmbajtje të tilla kanë bërë ueb-faqe që pretendojnë të paraqiten si medie, dhe që në metodologji të kontrollit të fakteve quhen si medie/portale të dyshimta.

Mirëpo, përcjellja e monitorimi i tyre ka qenë vështirë i mundshëm, për shkak të numrit të

madh të tyre dhe ndryshimeve të vazhdueshme që bëhen në domain-adresat e tyre. Për këtë arsye, “hibrid.info” ka krijuar një listë të këtyre ueb-faqeve si dhe faqeve në rrjete sociale, të publikuar në ueb-faqe, të cilën e përditëson kohë pas kohe<sup>2</sup>. Megjithatë, Kosova renditet e 12-a, në nivel global, sa i përket numrit të denoncimeve në këtë platformë, ndërsa para saj nga rajoni është vetëm Mali i Zi që ka bërë gjithsej 40 denoncime.

## 2. Bota: Përmbajtja mediatike dezinformuese

Lufta në Ukrainë duket se ka shërbyer si temë interesante edhe për shtete me distancë gjeografike nga vetë vatra e luftës. Këtë e dëshmon edhe numri i madh i publikimeve/postimeve me përmbajtje dezinformuese në shtete, si: India apo Brazili, të cilat gjeografikisht janë shumë larg Ukrainës. Vetë fakti që ka pasur numër të madh të shpërndarjeve të përmbajtjes së tillë

tregon se ka pasur edhe interesim nga lexuesit për ngjarjet përkatëse.

Duhet potencuar se numrin e madh të trajtimeve/denoncimeve për shtete e përcakton edhe numri i banorëve dhe kontrolluesve të fakteve që funksionojnë brenda një shteti, gjithashtu edhe gjuha.

<sup>2</sup> [Hibrid.info](https://hibrid.info) – Mediat e dyshimta




Për shembull, gjuha hindi flitet nga 342 milionë njerëz dhe renditet si gjuha e 4-të më e folur në botë, apo gjuhët hispanike fliten nga

471 milionë njerëz (përfshirë shumicën e shteteve në Amerikën Latine)<sup>3</sup>. Kjo ka bërë që numri i trajtimeve/denoncimeve në Indi e Spanjë të jetë i madh, pasi gjuhët e folura nga këto shtete përfshijnë një audiencë të gjerë botërore.

Në grafikun e mëposhtëm, pra, shohim se në krye gjenden trajtimet nga India e Spanja. Por pasohen nga shtete që mund të jenë afektuar më shumë nga ngjarjet si rezultat i efektit

ekonomik apo edhe të sigurisë, siç janë: Turqia, shtetet e rajonit të Ballkanit.

Kjo përqindje, gjithashtu, mund të jetë edhe shumë reprezentative sa i përket numrit të trajtimeve/denoncimeve të përmbajtjes dezinformuese. Kjo sepse në vendet si Rusia dhe Kina, por edhe në disa vende të rajonit të Azisë Qendrore apo edhe në disa shtete a vise të rajonit të Kaukazit, për shkak të raporteve të mira politike me regjimin aktual të Rusisë, nuk ka funksionim normal të kontrolluesve të fakteve, që janë anëtarë të IFCN-it.




**Figura 4.** Përqindja e denoncimit të dezinformatave në Rrjetin Ndërkombëtar të Kontrollimit të Fakteve (IFCN) në bazë të shteteve.

Video-përmbajtjet dezinformuese kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë më të shpërndarat në të gjitha vendet e botës. Ato janë të publikuara si të vetme, por edhe të kombinuara me tekst.

Pasojnë fotografitë si të vetme dhe të kombinuara me tekst. Ndërsa teksti dhe audioja mbesin si më pak, përkatësisht fare të përdorura gjatë kësaj periudhe hulumtimi.


<sup>3</sup>[Babel Magazine- The 10 Most Spoken Languages In The World](#)



**Figura 5.** Sipas të dhënave të IFCN-it, videoja dhe fotografia kanë dominuar sa i përket llojeve të përmbajtjeve mediatike të denoncuar si dezinformata.

Kanalet e përdorura për shpërndarje të përmbajtjeve dezinformuese janë kryesisht mediet sociale, ku dominon Facebook-u në më shumë se 50 %, i pasuar nga Twitter-i, Instagram-i e YouTube. Mbrapa nuk mbesin as platformat për komunikim që njihen


ndryshe si “Instant Messaging” si Whatsapp-i e Telegram-i. Por edhe mediet online përmbajnë një përqindje domethënëse edhe pse, edhe në rastin e tyre, përmbajtja është shpërndarë përmes kanaleve të lartcekura.



**Figura 6.** Numri i dezinformatave të denoncuar në IFCN në varësi nga kanali i transmetimit të tyre

Numri i lajmeve dhe postimeve me përmbajtje dezinformuese, sipas asaj që mund të shihet nga trajtimi/denoncimi i tyre ngakontrolluesit e fakteve ka filluar në masë të madhe nga 24 shkurti, kur ka filluar edhe pushtimi i ushtrisë ruse në të gjithë territorin e Ukrainës. Në grafikun pasues mund të shihet

se në ditët e para ka pasur një rritje të lartë, veçanërisht në dy ditët e para (24 e 25 shkurt) dhe pastaj denoncimi ka filluar të bjerë. Kurba, në këtë grafik, tregon se trendi është rritur sërish në ditët në vijim, por jo me intensitetin e ditëve të para të pushtimit.



**Figura 7.** Numri i denoncimeve të dezinformatave shihet se ka pësuar një rritje të madhe në ditët e para të invazionit të Rusisë në Ukrainë.

### 3. Narrativat e falsifikuara

Dezinformimi për dhe rreth ngjarjeve në Ukrainë ka filluar muaj e vite më parë. Sipas raporteve të organizatave perëndimore, ky dezinformim ka ardhur kryesisht nga mediet pro-regjimit në Rusi, të njohura në terminologjinë perëndimore si mediet pro-Kremlinit dhe akterëve të tjerë të afërt.

Në disa raportime mediatike të medieve kredibile perëndimore, është ngritur shqetësimi se audiencës brenda Rusisë u servohet një realitet tjetër nga mediet e

kontrolluara nga pushteti, në raport me atë që ndodh realisht në terren<sup>4</sup>. Intensifikimi i këtij lloji të dezinformimit të kontrolluar nga pushteti në Rusi, ka ndodhur pak javë para invadimit të ushtrisë ruse në rajonet separatiste ruse në Ukrainë, gjegjësisht në Donjeck e Luhansk, duke e paraqitur këtë intervenim ushtarak si një mision humanitar për rusët lokalë<sup>56</sup>. Ky fenomen ka shqetësuar edhe vendet perëndimore, Bashkimin Evropian, Britaninë e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

<sup>4</sup> [BBC- Ukraine: Watching the war on Russian TV - a whole different story](#)

<sup>5</sup> [EUvsDisinformation- The Kremlin's Playbook: Fabricating Pretext To Invade Ukraine - More Myths](#)

<sup>6</sup> [EUvsDisinformation - Forcefully Relocating 700,000 People, All To Spin More Disinformation](#)



#### **Fotografi ilustruese/Propaganda**

Në disa diskutime brenda BE-së është trajtuar seriozisht ndikimi i dezinformimit rus në gjendjen në terren. Shtetet anëtare kanë kërkuar nga platformat digjitale të njohura edhe si “Të mëdhenjtë e Teknologjisë” (Alphabet-it (Google), Amazon-it, Apple-s, Meta-s (Facebook-ut) dhe Microsoft-it) që ta reduktojnë e ta ndalojnë shpërndarjen e

përmbajtjes së dy medieve kryesore të pushtetit rus “Sputnik-ut” e “Russia Today-it”<sup>7</sup>.

Edhe Departamenti Amerikan i Shtetit ka publikuar disa narrativa të falsifikuara apo të manipuluar të Rusisë që synojnë të paraqesin këtë shtet si viktimë të një agresioni të pretenduar perëndimor<sup>8</sup>.

#### 4. Metodologjia dhe të dhënat

Në kuadër të këtij raporti janë përdorur vetëm rastet e atyre medieve që kanë prezencë digjitale, pra përmbajtjen e tyre e shpërndajnë në platformat online. Ato mund të jenë gazeta (jo në rastin e Kosovës), televizione, radio, medie online (portale). Përveç medieve, në raport trajtohen edhe përmbajtjet që janë shpërndarë në mediet sociale, platformat për komunikim online (Instant Messaging). Mostra e këtij raporti, në rastin e Kosovës,

është e përbërë prej 35 denoncimeve nga platformat “hibrid.info” dhe “kallxo.com” në bazën e të dhënave të krijuar në kuadër të IFCN-it (periudha 24 shkurt-11 mars 2022). Nga shtetet e rajoni, si: Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Bosnje dhe Hercegovina, Bullgaria dhe Kroacia janë bërë 156 denoncime (nuk ka pasur asnjë denoncim nga Maqedonia e Veriut). Ndërsa, në nivel global të dhënat trajtojnë 1403 denoncime që janë bërë nga e

<sup>7</sup> [Politico - Europe seeks a legal route to switch off Russian TV](#)

<sup>8</sup> [U.S. Department of State - Russia's Top Five Persistent Disinformation Narratives](#)

gjithë bota në dy javët e para pas invazionit të Rusisë në Ukrainë, pra nga 24 shkurti deri më 9 mars 2022. Të dhënat e trajtuara në këtë raport u janë ofruar hartuesve pas një kërkesë zyrtare drejtuar Rrjetit Ndërkomëbëtar të Kontrolluesve të Fakteve (IFCN) siç është shpjeguar më lart. Të dhënat janë trajtuar me programin për përpunimin e statistikave “IBM

SPSS Statistics”. Hapat e mëtutjeshëm metodologjikë në këtë raport përmbajnë të dhëna statistikore të trajtuara përmes metodave kuantitative relevante, të dhëna krahasuese ndërmjet variablave të të dhënave, si dhe trajtim të përmbajtjes dhe kontekstit përmes analizës së përmbajtjes.

## 5. Rekomandimet

### 5.1. Rekomandimet për redaksitë e lajmeve

- Duke pasur parasysh numrin e madh të dezinformatave që kanë shpërthyer së bashku me luftën në Ukrainë, rekomandohet që të aplikohen në përpikëri hapat e verifikimit të burimit të informacionit, duke i dhënë më shumë rëndësi saktësisë sesa shpejtësisë së publikimit të lajmeve.
- Burimet e informacionit në një zonë lufte, shpeshherë, mund të kenë qëllim përhapjen e propagandës, prandaj, është shumë me rëndësi që në rastin e lajmeve të publikuara nga dhe për këto rajone të aplikohet balancimi i informacioneve brenda lajmeve. Pra, rekomandohet të kenë kujdes që në rastet kur përmbajtja bazohet në një fakt të vetëm, të shfaqen rezerva dhe të pritët derisa të sigurohen fakte të tjera që e paraqesin “një pikturë më të plotë” të ngjarjes.
- Shumë shpesh konteksti i videove dhe materialeve të tjera të shpërndara në internet, qofshin ato të realizuara nga qytetarë të zakonshëm apo institucione të vendeve të përfshira në luftë, mund të jetë i manipuluar. Prandaj, në rastet e raportimit nga këto zona, rekomandohet të analizohet konteksti i ngjarjeve para publikimit.
- Në raste të raportimit nga kriza të tilla e të ngjashme është e rëndësishme që redaksitë të vendosin tituj sa më informues duke i lidhur ata me përmbajtjen e lajmeve. Në këto raportime, rekomandohet që të shmangen sa më shumë titujt senzacionalë duke qenë se një pjesë e lexuesve mund të informohen vetëm përmes titujve pa arritur ta lexojnë gjithë përmbajtjen.
- Përkundër përpjekjeve të redaksive për t'i verifikuar informacionet, lajme të pasakta mund të raportohen në medie. Prandaj, në këto situata u rekomandojmë redaksive që t'i korrigjojnë gabimet në raportim dhe t'i bëjnë të ditura korrigjimet, meqë në këtë formë mediet rrisin kredibilitetin e tyre.

## 5.2. Rekomandime për publikun

- Duke pasur parasysh që në platformat e medieve sociale dhe medieve online është një numër i madh i përmbajtjeve dezinformuese nga kriza e Ukrainës, rekomandohet që të kontrollohet koha që kaloni në këto platforma.
- Redaksitë e medieve të dyshimta, të cilave nuk u dihen pronarët, adresat, emrat e gazetarëve dhe redaktorëve kanë predispozita që të shpërndajnë më shumë përmbajtje dezinformuese. Prandaj, rekomandohet që lajmet që i lexoni/shikoni/dëgjoni, të jenë të transmetuara nga mediet kredibile.
- Para se t'i shpërndani përmbajtjet, zhvilloni një gjykim kritik për ato përmbajtje, meqë rrezikoni të jeni bartës të dezinformatave pa qëllimin tuaj.

